



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS – ASAMBLEJA E PËRGGJITHSHME E SHOQATËS TË BASHKIVE TË SHQIPËRISË

11 qershor 2012

Zv. Ministër Poni,
Kryetar Basha,
Kryetar Luka,
Znj. Cagnolati,
Z. Tonhauser,
Të nderuar miq,
Zonja dhe zotërinj
Mirëdita!

Dëshiroj të filloj duke falenderuar Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për mundësinë që të jem këtu me ju sot, midis një grupi drejtuesish të nderuar vendorë.

Më lejoni të përmend disa fakte që lidhen me një shërbim më të mirë ndaj publikut: Ju jeni zgjedhur për të sjellë ndryshim në jetët e qytetarëve të komuniteteve tuaja.

Ju jeni nëpunës publikë të një rangu të lartë dhe roli juaj është t'i shërbeni mirë publikut.

Detyra juaj është t'i shërbeni komunitetit dhe të ndihmoni në krijimin e një të ardhmeje më të mirë për njerëzit.

Kjo është me siguri një detyrë e rëndësishme dhe fisnike, e cila, ndonjëherë, bëhet po aq dhe sfiduese.

Shërbimi mund të përfshijë një aspekt tjetër, po aq të gjerë: si anëtarë të një shoqate që përfaqëson interesat e të gjithë bashkive, ju keni mundësinë të luani një rol madhor strategjik në zhvillimin e Shqipërisë.

Megjithatë, që kjo të ndodhë, Shoqata duhet të luajë rolin e një organi kombëtar të bashkuar, proaktiv dhe jo partiak, që avokon për interesat lokale dhe që mund të mbështesë punën që bën secili prej jush për zhvillimin dhe forcimin e ofrimit të shërbimeve publike vendore.

Duam t'ju nxisim të punoni në partneritet të vërtetë, përtej kampeve politike, që të loboni te qeveria qendrore për iniciativat që mund të kenë një ndikim të vërtetë në jetët e qytetarëve të zakonshëm.

Nga bisedat që kemi bërë me qytetarët e vendit tuaj dimë se ata shpresojnë dhe presin që ju të kryeni punën tuaj në mënyrë konstruktive, profesionale dhe jo partiake, në të mirë të interesave të tyre.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë duhet të sigurojë platformën ideale për promovimin e nevojave vendore, për ndarjen e informacionit dhe për zbatimin e praktikave më të mira.

Me sa e kuptoj unë, misioni i Shoqatës është "Të kontribuojë në mbrojtjen e interesave të përbashkëta të pushtetit vendor me qëllim përforcimin dhe zhvillimin e strukturave dhe mekanizmave demokratikë për organizimin dhe funksionimin e Bashkive në përputhje me Kartën Evropiane të Pushtetit Vendor."

Ajo duhet të krijojë një axhendë vjetore politikash dhe të nxisë koalicionet e gjera të nevojshme për të miratuar legjislacionin dhe për të parandaluar që legjislacioni të bjerë ndesh me interesat e njerëzve.

Dua të theksoj edhe një herë: një shoqatë e suksesshme ka nevojë për mbështetjen tuaj aktive pavarësisht bindjeve tuaja politike.

Do t'ju nxisja të bëni sa mundeni për të vendosur interesat e komuniteteve që ju përfaqësoni mbi interesat partiake.

Do t'ju lutesha të ndihmoni në krijimin e klimës së nevojshme të besimit dhe bashkëpunimit për të mundësuar funksionimin e Shoqatës.

Një Shoqatë që lobon dhe avokon për interesat e të gjitha Bashkive.

Një nga objektivat kryesore të aktivitetit të Shoqatës është krijimi i lidhjeve direkte me Kuvendin e Shqipërisë dhe me qeverinë për të mbrojtur interesat e Bashkive dhe për t'u bërë aktori kryesor në proceset politikbërëse për decentralizimin.

Shoqata përbën një mundësi të veçantë për diskutimin e problemeve dhe sfidave, për identifikimin e zgjidhjeve dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira.

Shoqata është një instrument që siguron qëndrueshmërinë e përpjekjeve të donatorëve duke zbatuar praktika të mira, instrumente dhe udhëzuesit mbi shërbimet publike të decentralizuara midis bashkive të interesuara në mbarë vendin.

Besoj se Grupi i Punës Sektorial mbi Decentralizimin ka nevojë për rolin kyç të një Shoqate funksionale për të përçuar zërin e Bashkive dhe për të përfaqësuar interesat e tyre.

Shoqata përfaqëson edhe Bashkitë në organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shërben si një facilitator i marrëdhënieve me partnerët, shoqatat homologe dhe organizatat ndërkombëtare për zhvillimin e programeve për bashkëpunim.

Prezenca e OSBE-së vazhdon të shohë një Shoqatë funksionale si një partner kryesor në përpjekjet e fundit për të promovuar Bashkëpunimin ndër-vendor si një përqsje për një ofrim me kosto më efektive të shërbimeve publike vendore në kontekstin e ndarjes administrative të fragmentizuar të territorit.

Zonja dhe zotërinj,

Të gjithë donatorët që punojnë për përforcimin e demokracisë vendore e shohin Shoqatën si një partner strategjik që përfaqëson interesat e të gjithë bashkive të afta për të drejtuar, promovuar dhe mbështetur përpjekjet e tyre në interes të pushtetit vendor në tërësi.

Bashkitë duhet të angazhohen më tepër me Shoqatën në mënyrë që të arrijnë rezultate në menaxhimin e territorit të tyre, që të përmbushin standardet ndërkombëtare, të bashkojnë kontributet e tyre dhe të kenë një instrument për të përfaqësuar problemet e përbashkëta përpara qeverisë dhe për zbatimin e çështjeve ligjore duke shkëmbyer praktikat më të mira.

Ju faleminderit!

Fund